



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1418 Prot.

Tiranë, më datë 23.09.2021

VENDIM  
Nr. 574, datë 23.09.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 "Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale", Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 "Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj", pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 23.09.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e Termave të Referencës në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit për "Dizenjimin e Projekteve për zonën qendrore të Amfiteatrit, Forumin Bizantin - Termat Romake dhe Shtigjet Urbane në Qytetin e Durrësit", financuar nga AADF:
  - Terma Reference për "Shërbime Konsulence\_Projektimi i rrugëve urbane për të ndërlidhur pasuritë kulturore të Durrësit";
  - Terma Reference për "Shërbime Konsulence\_Konservim, Prezantim/ Interpretim, Vlerësim dhe Planifikim i Gërmimeve Arkeologjike të Forumit Bizantin dhe të Termave Romake të Durrësit";
  - Terma Reference për "Shërbime Konsulence\_Konservim, Prezantim/ Interpretim, Vlerësim dhe Planifikim i Gërmimeve Arkeologjike në Amfiteatrin Romak të Durrësit".
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Arta DOLLANI

